

At de Fuko

[1858 ne Strasburg deri 1916 në algjeri]

Sharl de fuko, duke përshkruar një itimenar shpirtëror që e coi nga një jetë komode dhe luksoze dhe madje e paplotë, drejt një jete misionare, tregoi një ecje profetike për kohën tonë. Ai personalisht e vuri I pari theksin në imitim e jetës së fshehur nga nazareti, duke jetuar ne ngjashmëri të plotë në jetën e tij të përditshme, të fshehur një kërkim konkret dhe rrënjosës të vendit të fundit. Një figurë e tillë u flet në mënyrë të vecantë atyre që duke jetuar si lajik u duhet përballuar me sfidën për të dëshmuar ungjillin me jetën e tyre të përditshme. Gjithashtu është edhe një thirrje e fortë për të rizbuluar ungjillin në thellësinë e tij, dhe për të jetuar kështu sipas një stili të hapur në takim me të tjerët, dhe vecanërisht me të varfërin.

Janë të shumta komunitetet dhe shoqatat që frymëzohen nga at de fuko. pavarisht ai nuk themeloi asnjë, vëllai sharl gjatë gjithë jetës lutej, ëndërronte dhe shkruante rregulla për një komunitet vëllëzërisht monak e misionar. Edhe ne pavarisht nuk u nisëm nga përshpirtshmëriar e tij, dalluan nje nintoni te madhe ne momentin qe u hasën me shkrimet e tij me historin e tij.

Permendim ketu vecanerisht disa mesazhe profetike qe gjejmë në jetën e tij e që I ndjejmë plotesisht tonat.

Monak dhe misionare

Për disa shekuj me radhe ne kishë keto dy thirrje ishin të papajtueshëm më njëra tjetrën.

Ose nje person ishte monak, ose ishte misjonar.

Në sharl de fuko keto dy aspekte u njëtrajtësuan ne mënyre te mrekullueshme. Për të eukaristia ishte gjithcka :fakti që mund të zhyteshe në dashurinë e Jezusit pa llogaritur kohë dhe lodhje ishte tërheqja më e madhe. Në të njëjtën mënyrë zemra e tij ishte e hapur për cdo person. Vëllai sharl nuk ndalet vetëm në bashkëndarjen e gjërave të pakëta që ka [ushqimi, ilacet], një nevojë urgjente është të shfaqë ungjillin me jetën e tij. Të tregojë Jezusin me anë të mirësisë, me miqësinë, me pak fjalë të ketë një zemër të hapur ndaj të gjithëve, me një zemër prej vëllai të vërtetë.

Një stil I ri soditës

Për at de Fuko me anë të soditjes mund të ushqehemi vazhdimisht me ungjillin për të patur shikimin si të Jezusit mbi gjithcka. Mbi Zotin, mbi njerëzit, mbi realitetin. Jane pikërisht ato orët e gjata. në adhurimin eukaristik dhe zhytjes në ungjillin që e bënë at de fuko një monak të vërtetë, një soditës I zhytur në mision.

Një stil I ri misionari

Është stili që ka jetuar vetë Jezusi:të mishërosh, të respektosh, të bashkëndash, të bëhësh sa më shumë një I vetëm me njerëzit në varfëri, në gjuhë, në mentalitet duke e parë ungjillin të pranishëm tashmë në mes tyre. Një mjeku që e pyeti “Si te sillem me tuargezët?”, at de Fuko I përgjigjej: “Duhet të jeni I thjeshtë I besueshëm e I mirë me ta:ti duash e ti bësh të të duan. Buzëqeshni edhe kur thoni gjërat më të theshta. Unë sic e shikoni, buzëqesh gjithmonë. Buzëqeshja afron personat, I lejon ata të kuptohen më mirë, buzëqeshja është dashuria e vërtetë.